

PROFILER

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

PROFILER – Fungicid me veprim kontakti e sistemi për kontrollin e vrugut në hardhi. *Fosetyl-Al* ka veprim shumë të mirë sistemik dhe efektivitet të zgjatur. Vepron duke rritur në bimë përqëndrimin e substancave mbrojtëse natyrore si dhe duke dëmtuar direkt patogjenët. Në bimë, lëviz në të dy drejtimet dhe mbron bimët nga prekjet e vrugut në kërcell e rrënjë edhe thjesht me trajtimet gjethore. Megjithatë ka efekt kurativ, efekti më i mirë është kur trajtimet kryhen para çfaqjes së infeksionit.

Fluopicolide ka veprim kontakti dhe lëvizje translaminare në bimë. Depërton nga ana e sipërme e gjethes në anën e poshtme dhe anasjelltas. Në bimë lëviz nëpërmjet ksilemës. Nga baza e gjethes shpërndahet shpejt në të, por nuk lëviz nga një gjethë në tjetrën. Në hardhi, gjethet e dala nga një syth i trajtuar në çelje, janë të mbrojtura. *Profiler*, si kombinim i të dy lëndëve aktive, ka veprim kontakti dhe sistemi. Duhet të përdoret në trajtime parambrojtëse. Është efektiv për kontrollin e sëmundjeve të shkaktuara nga kërpudhat Oomycete (*Phycomycete*) si: *Plasmopara*, *Pseudoperonospora*, *Peronospora*, *Bremia*, *Phytophthora* si dhe *Pythium*. Ka veprim parambrojtës por edhe antispোরulant.

Lënda vepruese: *Fosetyl-aluminium 66,67%+fluopicolide 4,44%*

Formulimi: *Granula të dispergueshme në ujë (WG)*

Ngjyra: *Bezhë e lehtë*

Masat parambrojtëse:

Ruhet larg mundësisë për tu arritur nga fëmijët, larg kontaktit me ushqimet e njerëzve, ujin dhe ushqimin e kafshëve.

P280: Vishni dorashka mbrojtëse/rroba mbrojtëse/mbrojtëse për fytyrën/sytë.

EUH401: Për të shmangur risqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mjedisit, zbatoni udhëzimet për përdorimin. Gjate punës mos hani dhe mos pini lëngje e duhan.

Lani duart dhe pjesët e ekspozuara të lëkurës me ujë dhe sapun.

P501: Asgjësoni kontenierin sipas rregullave në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

Këshillë e përgjithshme: Largojuni nga zona e rrezikshme. Vendoseni dhe transportojeni viktimën në pozicion stabile (shtrirë anash). Hiq menjëherë rrobat e ndotura dhe asgjësoji në mënyrë të sigurtë.

H335: Mund të shkaktojë irrimtim në frymëmarrje. *Nëse merret me frymëmarrje:* Dil në ajër të pastër. Mbajeni pacientin të ngrohtë dhe të qetë. Telefoni menjëherë mjekun.

Nëse bije në kontakt me lëkurën: Lajuni tërësisht me ujë të bollshëm dhe sapun, nëse keni, me polyethyleneglycol 400, duke vazhduar shpëlarjen me ujë. Nëse simptomat vazhdojnë, kërkon ndihmë mjekësore.

H319: Shkakton irrimtim serioz të syve. *Nëse bije në kontakt me sytë:* Shpëllaj menjëherë me ujë të bollshëm, gjithashtu nën qepalla, për të paktën 15 minuta. Hiq, nëse ke i ke vendosur, lentet e kontaktit. Nëse shqetësimi vazhdon pas 5 minutave të para, vazhdo të shpëllajsh sytë. Kërko ndihmë mjekësore nëse irrimtimi shtohet dhe vazhdon.

H302: E dëmshme nëse gëlltitet. *Nëse gëlltitet:* Shpëllaj gojën. MOS shkakto të vjella. Nëse simptomat vazhdojnë, kërko ndihmë mjekësore.

Trajtimi: Lavazhi i stomakut normalisht nuk kërkohet, megjithatë, në rast gëlltitje të sasive të mëdha (më shumë se një gojë plot) këshillohet përdorimi i karbonit aktiv dhe sulfatit të natriumit. Nuk ka antidot specifik. Trajtimi simptomatik.

Përdorimi:

Përdoret për kontrollin e vrugut të hardhisë, me 2.5-3 kg/ha, ose me 0.3% (300 gr/100 lit ujë, për të spërkatur 1000 m²).

Në vartësi të mjetit spërkatës, dendësisë dhe formës së hardhive, stadi të zhvillimit, etj., përdoret 200-1500 lit tretësirë spërkatëse. Përdoret nga fillimi i rritjes së gjetheve deri në fillim të ndryshimit të ngjyrës së kokrrave. Gjatë të njejtit sezon, përdoret deri 3 herë, me interval 10-14 ditë, në vartësi të infeksionit.

Kur përdoret gjatë periudhës nga përfundimi i lulëzimit deri kur kokrrat janë sa madhësia e një kokrre gruri dhe veshulët fillojnë të varen (BBCH 71-73), ka gjithashtu efekt dytësor kundër kalbëzimit gri (*Botryotinia fuckeliana*).

Vërejtje për përdorimin:

Volumi i tretësirës spërkatëse duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar lagje të mirë të masës gjethore.

Përdoret i alternuar me produkte të tjera me mekanizëm të ndryshëm veprimi, për të evituar çfaqjen e rezistencës. Mund të përdoret edhe në trajtime në bllok, por jo me tepër se 3 herë.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik nëse përdoret sipas rekomandimeve.

Ndikimi në ekosistem:

Pak helmues për gjitarët, zogjtë dhe për bletët. H410: Shumë toksike për jetën ujore me efekte afatgjata. Mos ndotni ujrat dhe burimet ujore që rrjedhin në lumenj e rezervuarë uji. SPe3: Për të mbrojtur organizmat ujorë respektoni një zonë tamponësh të patrajtuar prej 10 m në rrjedhjet ujore sipërfaqësore.

Karenca:

21 ditë.

Ruajtja dhe magazinimi:

Ruhet në vende të thata, të ajrosura, larg rrezeve direkte të diellit, në temperaturë 0-30°C.

Nr dhe data e regjistrimit: 735; 24.4.2020;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 kg.

Data e prodhimit: *Printuar nga makineria në ambalazh*;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 4 vite;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese: *Printuar nga makineria në ambalazh*;

Tipi i ambalazhit bazë: material 3 shtresor me film me përbërje alumini (min. 0,007 mm alumin).

Emri dhe adresa e Aplikantit: Bayer d.o.o. **Adresa:** Ljubljane, Sloveni.

Fabrikuesi i PMB-së: Bayer AG. **Adresa:** Leverkusen, Gjermani.